



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:174726

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05643807

KF.nr.169/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Ena Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811168261, me seli në Drenas, rr. “Jasharajve”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mimoza Zabeli Sinani avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi , në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 19.04.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Mimoza Zabeli Sinani, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Ena Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811168261 dhe seli në Drenas, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi nr.prot.143/2021 I datës 30.06.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës, me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 06.08.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.143/2021 të datës 30.06.2021. Përfaqësuesja e autorizuar e palës paditëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se bazuar në dispozitat ligjore provat dhe

shkresat e lëndës si dhe gjendjen faktike, arsyetimin e vet vendimit të paditurës, por edhe në përgjigjen në padi padyshim se gjatë këtij procesi gjyqësor do të vërtetohet se e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit të atakuar nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit mbi ATK-në dhe udhëzimeve administrative në bazë të së cilave është e obliguar të veproj. Kështu duke rezultuar me vlerësim të gabuar jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Gjatë realizimit të kontrollit në objekt tatimit mbi vlerën e shtuar TVSH për periudhën 2014-2019, tatimi në korporata. Vendimi i të paditurës ka të meta juridike pasi që i njëjti është nxjerrë duke u bazuar dhe aplikuar standarde të dyfishta në veçanti në pjesën ku ka përcaktuar pozitën e hyrjeve, duke mbështetur vlerësimin dhe metodat të cilat marrin për bazë informacionet jashtë librave dhe regjistrimeve formale, ndërsa për pranimin e shpenzimeve ka kërkuar që dokumentet të jenë formale, andaj si rrjedhojë e kësaj kundërligjshmërie ka ngarkuar paditësin me tatimin si në raportin. Konsiderojmë se vendimi i atakuar nuk është bazuar drejtë në bazën e të gjitha burimeve tatimore duke mos aplikuar drejtë nenin 38 dhe 41 të Ligjit 05/L-037 të tatimit mbi Vlerën e Shtuar për Investimet, kështu duke mos ia pranuar investimet paditësit. Përkundër faktit se në vendimin e kontestuar deklarohet se paditësja ka tërhequr faturat e blerjes të materialit ndërtimor, paditësja në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë të paditurës ka deklaruar se pas konsultimit edhe me departamentit e shërbimit ka marrë përgjigje nga e njëjta se blerjet nuk duhen të largohen nga librat, sepse ato mbesin llogari të pagueshme duke kërkuar që këto fatura të mos largohen pasi të njëjtat janë të realizuara në emër të investimit të paditësit. Në fjalën përfundimtare ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar që të anulohet pjesërisht vendimi i të paditurës, të obligohet e paditura që paditëses ti njeh diferencën prej 24,051.69 euro për të gjitha llojet e tatimeve dhe ndëshkimit të përcaktuar me vendimin kontestuese, ndërsa shumën e paguar sipas marrëveshjes së arritur me të paditurën ti kthen paditëses dhe atë me kamatë ligjore të përcaktuar nga Ministria e Financave të Republikës së Kosovës që nga data e paraqitjes së padisë në afatin prej 15 ditëve nda dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 21.03.2021 ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte dhe vlerëson se Vendimi i ATK-së nr.143/2021 i datës 30.06.2021 ka mbështetje ligjore dhe faktike dhe është në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, për ç' arsye do të adresohen pretendimet e paditësit dhe të njëjtat do të argumenton për të vërtetuar pa besueshmërinë e tyre, së bashku me sqarime shtesë. Lidhur me pretendimet e paditësit për mos njohjen e TVSH-së së zbritshme për periudhën e kontrollit tatimor dhe faturat blerëse konstaton

se paditësi nuk ka vërtetuar këto pretendime dhe si të tilla i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuar duke e bazuar qëndrimin e saj në nenin 57 të UA 03/2015. Lidhur me pretendimet për blerjet e paguara përmes llogarisë bankare, paditësi nuk ka arritur që të siguroj dokumentacionin – listën e furnitorëve për të cilët pretendon se është në obligime si dhe transaksione të bankës me të cilat do të vërtetoheshin pagesat e përsëritshme që pretendohet të jenë paguar në vitet 2019, 2020 dhe 2021 pas periudhës së kontrollit tatimor. Paditësi nuk ka vërtetuar të kundërtën e vlerësimit tatimor dhe argumentuar pretendimet e ngritura gjatë ankesës dhe në gjykatë. Tutje ka shtuar se lidhur me kontestin e mos pranimit të investimeve, e paditura ka vërtetuar se paditësi e ushtron veprimtarin e tij në objektin i cili është me qira nga G.B.K. (prindi i aksionarit), mirëpo paditësi nuk ka arritur të prezantoj pëlqim në përputhje me nenin 3.6 të marrëveshjes me qira në të cilën parashihet se qiramarrësi nuk mund të bëjë ndryshime strukturale apo dekorative në lokalet afariste të marra me qira pa aprovimin paraprak me shkrim nga qiradhënësi. Objekti afarist i përket vëllait të aksionarit dhe jo paditësit. Lidhur me faturat investive vërtetohet se të njëjtat përmbajnë material si dyer dritare hekur çimento etj. Me çka vërtetohet se të njëjtat nuk ka janë artikuj që do të vërtetonin investimet në lokalin ku paditësi ushtron veprimtarinë dhe se për tu njohur si shpenzime duhet të jenë të argumentuara konform nenit 9 të Ligjit nr.05/L-029. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet plotësisht kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet si plotësisht i bazuar vendimi i kontestuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.04.2024 për të paditurën nuk ka prezantuar askush, por me parashtresën e datës 17.04.2024 ka njoftuar gjykatën se nuk mundë të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që gjykata të veproj sipas nenit 38 paragrafi 5 i Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ. Me parashtresën e po të njëjtës datë ka kundërshtuar pjesërisht ekspertizën financiare të punuar nga eksperti financiar S.M. me të cilën ka theksuar se faturat investive përmbajnë material me çka të njëjtat nuk janë artikuj që do të vërtetonin investimet në lokalin ku paditësi ushtron veprimtarin dhe se për tu njohur si shpenzime ato duhen të jenë të argumentuara konform nenit 9 të Ligjit nr.05/L-029, me tej shton se paditësi i ka larguar nga librat e blerjes të gjitha faturat e materialit investuese dhe se shuma e investimeve nuk është raportuar në asnjërin vit si pasuri e subjektit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 19.04.2024, ka administruar provat dhe atë: vendimin kontestues 143/2021, vendimin 266/2020 datë 06.10.2020, marrëveshje mbi mbështetjen financiare e datës 30.05.2014, ankesë e datës 13.08.2020, raporti i kontrollit i datës 30.03.2021, dokumentacioni rreth investimit dorëzuar nga paditësi e shoqëruar me fatura,

profatura, transaksione bankare, parashtresë e paditësit e datës 19.04.2024, marrëveshje për pagesën e borxheve tatimore, kontratë e datës 29.05.2016, ekspertizë financiare e datës 21.02.2024, përgjigje në padi, pasqyra e tatim paguesit printuar me datë 21.03.2022 dhe gjendja e borxheve.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka caktuar rikontroll tek paditësi, me ç' rast objekti i kontrollit ka qenë tatimi mbi vlerën e shtuar për periudhën 05/2014 – 12/2018 dhe CD 2014-2018, ku është konstatuar se ka pasur ulje kreditimi për periudhat që ishin objekt kontrolli në vlerë prej 33,316.740 euro, tatim shtesë për pagesë në vlerë prej 24,110.35 euro dhe ndëshkime prej 6,027.59 euro. Jo kontestuese mbesin edhe fakte se tatimpaguesi me datë 26.04.2021 ka dorëzuar ankesën në Divizionin e Ankesave në ATK, për të cilën ankesë ATK-ja me datë 30.06.2021 ka nxjerr vendimin nr.143/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtui paditësit, e ndaj të cilin vendim paditësi me padinë e datës 06.08.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi, përgjigjes në padi dhe shkresave të lëndës, me aktvendimin KF.nr.169/22 të datës 15.02.2024 duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar S.M., me detyrat përkatëse si në dispozitiv të aktvendimit të lartcekur.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 21.02.2024 në sqarim dhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 19.04.2024, nga ana e ekspertit financiar S.M., për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi ku i njëjti ka konstatuar se: *faturat kontestuese i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 45 të Ligjit mbi tatimi mbi vlerën e shtuar, të gjitha faturat janë të paguara nga llogaria bankare e paditësit dhe të njëjtat janë të regjistruara në librin e blerjes të subjektit Ena Group.*

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale, mendimit të ekspertit, vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Sipas nenit 57 të Udhëzimit Administrativ UA nr. 03/2015, paragrafi 2.2 është përcaktuar se *“Për të ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme sipas nenit 37, paragrafit 3.2 dhe nenit 36, paragrafit 2.1 të Ligjit, për mallrat e furnizuara brenda vendit, kërkohen këto dokumente: dhe me paragrafin 2.2.1. specifikon se “Fatura tatimore e lëshuar nga personi i tatuëshëm i regjistruar për TVSH dhe e cila përmban të gjitha elementet e parapara me nenin 45 të Ligjit; 2.2.2. Nota debitore e lëshuar në pajtim me nenin 47 të Ligjit; Tutje në paragrafin 2. 3 është përcaktuar se Krahas dokumenteve të sipërpërmendura, për të ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së, kërkohen edhe dokumentet, si në vijim:., Ndërsa në paragrafin përcaktuar se 2.3.2. Dëshmi në lidhje me pagesën, në përputhje me dispozitat e parapara në Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.*

Gjykata gjetjet e raportit të kontrollit dhe konstatimet në vendimin kontestues lidhur me mos pranimin e TVSH-së së zbritshme të investimeve dhe blerjeve, i konsideron si tërësisht të bazuara, kjo për faktin se tatimpaguesi, këtu paditësi nuk ka ofruar dëshmi as tek e paditura e as në këtë gjykatë prova me të cilat do të dëshmonte pagesën për këto fatura. Edhe nga ekspertiza financiare, gjykata konstaton se në gjetjet e inspektorit nuk është vërtetuar se të njëjtat janë paguar përmes transaksioneve bankare, ndërsa konstatimin e ekspertit se faturat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore sipas nenit 45 të Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar, i konsideron si të pamjaftueshme lidhur me bazueshmërinë, pasi që vetëm rregullsia e faturës nuk mund të pranohet në rastet kur kërkohet zbritja e TVSH-ës, sepse edhe siç është elaboruar në dispozitën e lartcekur, duhet të ekzistojnë dëshmi në lidhje me pagesën dhe jo vetëm fatura të rregullta.

Gjykata gjetjeve nga ekspertiza nuk i fali besimin, kjo meqë vet ekspertiza për disa fatura konstaton se janë paguar “Cash” apo para të gatshme, nga paditësja e që shumat tejkalojnë shumën e paraparë ligjore, respektivisht vlera e të cilave është mbi 500 euro e që është në kundërshtim me nenin 13 par 7 të Ligjit 03/L-222 , me të cilën shprehimisht përcaktohet se *“Çdo transaksion mbi pesëqind (500) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare”*.

Andaj, Gjykata vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e të paditurës me të cilën është refuzuar ankesa e paditësit ndaj njoftim vlerësimeve për faturat investive të paguara në cash, respektivisht në kundërshtim me neni e lartcekur.

Lidhur me kontestin e faturave investive dyer dritare, hekur etj., nuk është arritur të argumentohet e kundërta nga gjetjet e inspektorit tatimor, sepse paditësi nuk ka arritur të prezantoj pëlqim në përputhje me nenin 3.6 të marrëveshjes me qira në të cilën parashihet se qiramarrësi nuk mund të bëjë ndryshime strukturale apo dekorative në lokalet afariste të marra me qira pa aprovimin paraprak me shkrim nga qiradhënësit, ndërsa kontrata e dorëzuar gjatë seancës ku paditësi paraqitet si investitor i objektit afarist, nuk është provë e re të cilën nuk e ka poseduar e paditura, pasi që e njëjta edhe është deklaruar lidhur me këtë kontratë se sipas lejes ndërtimore për këtë objekt paraqitet pronar vëllau i paditësit dhe jo paditësi dhe se pavarësisht kontratës, këto investime nuk mund ti njihen këtu paditësit për veprimtarinë të cilën e ushtron. Ndërsa lidhur me investimet për objektin afarist i njëjti nuk ka dëshmuar se ka mbajtur libra të veçantë të ndërtimit, nuk ka aplikuar ngarkesën e kundërt dhe nuk ka aplikuar koeficientin e kreditimit për TVSH për pjesën e banimit.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit se vendimi i kontestuar është i paargumentuar dhe si i tillë është pa bazë ligjore, kjo për faktin se e paditura ka konstatuar drejtë se tatimpaguesi, këtu paditësi nuk ka argumentuar të kundërtën e vlerësimit zyrtar të ATK-së siç parasheh neni 11 par 6 i Ligjit Nr.03/L-222, me të cilin përcaktohet se *“Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë”*.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se aktvendimi e kontestuar është i kuptueshëm, i qartë, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Gjykata konstaton se në këtë kontest tregtar administrativ, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Mbi këtë gjendje të fakteve, deklaramit të palëve, ekspertizës financiare të datës 21.04.2024, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr.143/2021 i të paditurës, me të cilin është refuzuar ankesa e këtu paditësit është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.1 dhe nenit 46 par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.169/22, datë 19.04.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.